



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202500172/14

Tiranë ____/____/2025

Lënda: *Rekomandim për përshpejtimin e përfundimit të procedurës administrative të filluar mbi bazën e vetëdeklarimit për legalizim, të paraqitur nga shtetasi A. K.*

Drejtuar: **Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

KORÇË

Për dijeni: **Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**
Adresa: Rruga "Dora D'Istria"

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka administruar dhe pranuar për shqyrtim ankesën¹ e shtetasit A. K. . Në këtë ankesë, shtetasi A. K., ankohet ndaj Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), Korçë, për mospërfundim të shqyrtimit të vetëdeklarimit të kryer nga ana e tij për legalizimin e ndërtimit informal të ndodhur në Korçë, i cili është administruar prej DVASHK, Korçë.

Sikundër ai shkruan, vetëdeklarimi për legalizimin e ndërtimit informal të kryer prej tij dhe në posedim të tij, është kryer në vitin 2008, dhe se, procesi administrativ ende nuk ka përfunduar.

¹ Datë 14.04.2022, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit

Për ecurinë e procesit, ankuesi shprehet se është interesuar në vazhdimësi por deri më sot procesi nuk ka përfunduar. Ai shprehet se, prej punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Korçë, janë kryer matje në terren të ndërtimit informal, dhe se, nga ana e tij, është mundësuar vënia në dispozicion e çdo dokumentacioni të kërkuar si dhe paguar çdo tarifë shërbimi. Nga dita e aplikimit të vetëdeklarimit për legalizim të ndërtimit informal, ankuesi, shprehet se, ka marrë informacione jo zyrtare se do të përfundojë shqyrtimi i vetëdeklarimit.

Në këto rrethana, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje ju jemi drejtuar me shkresën tonë nr. K3/A27-13 prot, datë 02.05.2024, *“Kërkesë për shpjegime”*, për dhënien e informacionit dhe shpjegimeve lidhur me, arsyet e mostrajtimit në kohë dhe sipas afateve ligjore të kësaj çështjeje, si dhe të masave që do të merren nga ana juaj në vazhdim, për zgjidhjen përfundimtare të saj.

Në përgjigje të kërkesës, ju me Tuajën nr. 1310/1 prot., datë 16.05.2024, informoni midis të tjerave, se:

“... Z. A. K., rezulton aplikues në vetëdeklarimin nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx për një ndërtim informal të ndodhur në Korçë. Pas verifikimit të dokumentacionit që administrohet në praktikën e legalizimit, rezulton që në bazë të proces verbalit të verifikimit në terren të ndërtimit informal, objekti në posedim të z. A. K., ndodhet midis kopshtit dhe çerdhes të lagjes. Me shkresën nr. 8795 prot, datë 11.12.2019, i është kërkuar informacion zyrtar Bashkisë, Korçë, nëse objekti në posedim të z. A. K., cenon objektin dhe/ose territorin e institucionit publik arsimor.

*Në përgjigje të saj, Bashkia, Korçë, me shkresën nr. 11775/1 prot, datë 01.06.2020, ... na ka vënë në dispozicion informacionin që institucioni publik arsimor, i cili ndodhet në kufi me ndërtimin, objekt i kërkesës suaj, **cenohet nga ky ndërtim informal**, pasi për funksionimin e tualeteve të kopshtit dhe për ndërhyrjen në kanalizime, nevojitet një metër distancë midis ndërtimit informal dhe institucionit arsimor.*

Ndodhur në kushtet e mësipërme është e pamundur vijimi i procedurës administrative të legalizimit të ndërtimit informal në posedim të z. A. K.”.

Referuar përgjigjes së sipërcituar, konstatohet se:

- Përfundimi i shqyrtimit të vetëdeklarimit nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx, kryer prej ankuesit për legalizimin e ndërtimit informal të ndodhur në Korçë, është në shkelje të afatit të parashikuar në ligj, që ishte në fuqi në kohën kur ankuesi ka bërë vetëdeklarimin, për rrjedhojë, është cenuar parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse parashikuar në nenin 42² të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Konstatohet se, vetëdeklarimi për legalizimin e ndërtimit informal prej ankuesit, është kryer kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar. Sipas nenit 4 të këtij ligji, parashikohej Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale

² Neni 42 i Kushtetutës parashikon: *“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

(ALUIZNI), sot ASHK, organi përgjegjës për dhënien e lejes së legalizimit mbi bazë të zhvillimit të një hetimi të plotë e të gjithëanshëm administrativ, brenda afateve ligjore³.

- Nuk ka ende një vendimmarrje nga ana e DVASHK, Korçë, lidhur me vetëdeklarimin e kryer prej ankuesit, në vitin 2008, për legalizimin e ndërtimit informal, edhe pse disponohet informacion rreth mundësisë ose jo të legalizimit të tij;
- Vërehet komunikim dhe informim i ankuesit nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore që trajtojnë vetëdeklarimin e tij, por pa shkak ligjor, nuk konkludohet prej DVASHK-së, Korçë, me nxjerrjen e aktit përfundimtar në këtë procedurë administrative të nisur mbi bazë të vetëdeklarimit të tij për legalizimin e ndërtimit informal.

Në referim të legjislacionit në fuqi, konstatohet në vijim se:

Së pari: Kalimin e një kohë tejet të gjatë që nga momenti i aplikimit/vetëdeklarimit për legalizimin e objektit informal të paraqitur nga ana e z. A. K., pranë organit kompetent sipas legjislacionit në fuqi të kohës. Pra, janë 17 vite, përgjatë të cilave po zhvillohet një procedurë administrative, ende e papërfunduar. Pra, DVASHK, Korçë, pa shkak ka mbajtur dhe mban qëndrim pasiv në përfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimit të ankuesit. Ky qëndrim i DVASHK, Korçë, vjen ndesh me parimin e administrimit proaktiv dhe shërbimit ndaj qytetarit.

Afro 17 vite pritje janë në tejkalim ekstrem të çdo afati të arsyeshëm. **E drejta për një administrim efikas dhe të drejtë** është e garantuar nga ligji dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

DVASHK, Korçë, si organ përgjegjës për përfundimin e procedurës, ka **detyrimin ligjor dhe institucional** për të ndjekur dhe përfunduar procedurën administrative të legalizimit pas paraqitjes së vetëdeklarimit nga qytetari. Në momentin që qytetari ka depozituar vetëdeklarimin, **ngarkohet organi publik me detyrimin për të vijuar procedurat:** verifikimin në terren, miratimin e hartës së pronës, nxjerrjen e vendimit për legalizim, e më tej përgatitjen/lëshimin e dokumentacionit të pronësisë. Zvarritja për një periudhë kaq të gjatë (nga viti 2008) është **një dështim i pajustificueshëm i DVASHK, Korçë**, në përmbushjen e funksioneve të saj, që përbënë edhe shkelje të të drejtave të qytetarit sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ (e drejta për një proces të rregullt dhe në kohë të arsyeshme).

Kalimi i një periudhe shumë të gjatë (që nga 2008) pa vendimmarrje është i pajustificueshëm dhe përbën **shkelje të të drejtës për një administrim në kohë të arsyeshme**.

Së dyti: Nuk paraqitet nga ana juaj si organ publik asnjë justifikim ligjor për këtë kohëzgjatje faktike të procedurës administrative, ende të papërfunduar. Kjo situatë ndodh kur, me sa rezulton nga informacioni i dhënë prej jush, i moskuptimit të detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit përfundimtar⁴ dhe në kushtet kur vlerësohet mosplotësimi i kriterëve për kualifikimin e ndërtimit pa leje⁵.

³ Në nenin 10 të ligjit nr. 9482/2006, parashikohej se: "... Në rast se pas kalimit të afateve, zyrat e urbanistikës apo këshillat e qarqeve, nuk ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen, atëherë ALUIZNI merr përsipër ushtrimin e tyre. Afatet, mënyra dhe koha e ushtrimit të këtyre përgjegjësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

⁴ Në nenin 90, paragrafi 1, të K.P.A. parashikohet se: "Përfundimi i procedurës administrative. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrative apo një kontratë administrativ. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij".

⁵ VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për

Në rastin kur një organ publik merr një kërkesë apo ankesë nga një subjekt/qytetar për një çështje për të cilën **nuk ekziston një zgjidhje e parashikuar në legjislacionin në fuqi**, ose për të cilën **organi nuk ka kompetencë apo mjet juridik për ta zgjidhur**, ai **duhet të japë një përgjigje të arsyetuar**, duke u bazuar në parimet e administratës publike, transparencës dhe të drejtës për informacion.

Nisur nga rrethanat e parashtruara në këtë çështje si dhe nga informacioni i paraqitur nga ana juaj si drejtori vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, evidentohet qartësisht fillimi i një procedure administrative të bazuar në rregullimet e një legjislacioni specifik, mbi legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,⁶ e cila, pas 17 vitesh nuk ka përfunduar ende, me nxjerrjen e një akti administrativ (*vendim përfundimtar*), nga organi përgjegjës publik, në të cilin vendoset legalizimi, ose jo, i objektit përkatës, të ngritur pa leje ndërtimi.

Vetëdeklarimi për legalizim është kryer nga z. A. K., me aplikimin/ vetëdeklarimit nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx. Në varësi të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi të kohës, për trajtimin e këtij vetëdeklarimi dhe nga analiza e të gjithë afateve ligjore procedurale të vendosura nga ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", të ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar nga ligji nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", nuk përcaktohej një afat konkret kohor, brenda të cilit duhej të përfundonte procedimi administrativ, me nxjerrjen e një vendimi për legalizimin, ose jo, të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi.

Në referencë të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative,⁷ koncepti i procedimit/procedurës administrative, që në këtë problematikë lidhet me aplikimet rast pas rasti për legalizim të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi, është një proces që iniciohet nga një subjekt që ka interes të drejtëpërdrejtë në këtë çështje, vazhdon me zhvillimin e procedurave administrative (brenda afateve ligjore dhe gjatë të cilave mund të nxirren edhe vendime të ndërmjetme administrative), dhe përfundon me nxjerrjen e aktit administrativ përkatës, prej organit publik përgjegjës.

Në varësi të kohës së kryerjes së vetëdeklarimit nga z. A. K., të legjislacionit specifik në fuqi të kohës, për trajtimin e këtij aplikimi, si dhe në mungesë të një afati kohor taksativ të dhënë në këtë legjislacion specifik, për përfundimin e procedimit/procedurës administrative për këtë rast konstatojmë se, nuk jemi në një rast vakumi ligjor të përcaktimit të këtij afati (dhe aq më pak në kuptim të konceptit të përfundimit të procedurës brenda një afati të arsyeshëm), pasi në nenin 49, paragrafi 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", parashikohej se:

të kualifikuar ndërtimet pa leje", shfuqizuar me VKM-në në fuqi nr. 1040, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje"..

⁶ Në varësi të kohës së vetëdeklarimit për përfshirje në procesin e legalizimit, duhet të mbahet parasysh si bazë ligjore, ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar, si dhe ligji nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*".

⁷ Në këtë përcaktim është mbajtur parasysh përmbajtja e dispozitave të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe ligji nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", (i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999).

“Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta, ose kur imponohet nga situata të veçanta. Në rastin e situatave të veçanta, procedimi administrativ përfundon 3 muaj pas ndërprerjes së situatës, së veçantë”.

Po ashtu, edhe Kodi i Procedurës Administrative në fuqi, parashikon në nenin 91, një afat eksplisit për përfundimin e procedurës administrative⁸.

Procesi i legalizimit i parashikuar dhe rregulluar me ligj, është një proces që bazohet në vullnetin e lirë të subjekteve të cilët, megjithëse efektivisht kanë kryer një shkelje ligjore, kanë të drejtën dhe mundësinë që të “korrigjojnë” atë, përmes kërimit të fillimit dhe zhvillimit të një procedure administrative, e cila mbart detyrime dhe të drejta për ata vetë në radhë të parë, por dhe për organet përgjegjëse të administratës publike, të përfshira në proces.

Nuk duhet harruar nga ana tjetër se, ky proces tashmë i emërtuar kalimtar⁹ nga legjislacioni në fuqi, është i lidhur me një sërë procesesh të tjera shumë të rëndësishme, sikurse ai i kthimit dhe kompensimit të pronës ish-pronarëve, regjistrimit përfundimtar të pasurive të paluajtshme, zhvillimit urban të zonave të banuara, etj.

Në këto kushte, çdo vonesë në procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve pa leje, jo vetëm lidhet me respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të subjekteve që kanë aplikuar për t’u përfshirë në të, por paraqitet edhe si një vonesë, apo pengesë me pasoja konkrete edhe për të gjithë zinxhirin e proceseve të tjera administrative-ligjore, të lidhura me të.

Mosrespektimi rast pas rasti i këtij afati ligjor të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi i kohës, ka krijuar probleme në vetë punën e organeve të administratës publike të përfshira në procesin e legalizimit, ka krijuar probleme tek subjektet vetëdeklaruese/aplikuese dhe rrjedhimisht, ka krijuar probleme në shumë procese të tjera ligjore që ndërthuren përgjatë zhvillimit të tyre me procesin e legalizimeve.

⁸ “Afati për përfundimin e procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.

2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.

4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

5. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme”.

⁸ Neni 42 i Kushtetutës parashikon: “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

⁹ Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Situata e krijuar evidenton problematikën tërësisht të pajustificuar të kohëzgjatjes së një procedure administrative prej mëse 17 vitesh (ende të papërfunduar), si në rastin e vetëdeklaruesit/aplikuesit z. A. K., ku megjithëse ky i fundit ka aplikuar që në vitin 2008, për legalizim të ndërtimit pa leje, ende nuk ka një vendim përfundimtar për këtë procedurë.

Sjellim në vëmendje gjithashtu, faktin se, specialistët e terrenit kanë kryer tashmë verifikimet në terren të ndërtimit informal në posedim të ankuesit, dhe se, z. A. K., ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar tekniko-ligjor. Me rastin e evidentimit në terren të ndërtimit informal nga punonjësi juaj, DVASHK, Korçë, në referim të përcaktimit në pikën 20 të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020, *“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”*¹⁰ duhet të kish përfunduar procedurën administrative në shqyrtimin e vetëdeklarimit nr. 5xx, Kod Unik 07-100xxxx të ankuesit.

Përgjigja e dhënë nga ana juaj me shkresën nr. 1310/1 prot., datë 16.05.2024, lë përshtypjen e moskuptimit nga ana juaj të detyrimit për nxjerrjen e aktit përfundimtar edhe kur ndërtimi informal nuk plotëson kriteret për kualifikim.

Mosveprimi dhe zvarritja tërësisht e pajustificuar ligjërisht, e konstatuar në këtë çështje nxjerr në konkluzionin se, kemi të bëjmë me cenim të së drejtës themelore të z. A. K., për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Avokati i Popullit është në dijeni të numrit shumë të lartë të aplikimeve për legalizim, që janë për t’u shqyrtuar nga ana e drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, por nga ana tjetër nuk ka arsye që ky komunikim formal e zyrtar, të mos gjejë reflektimin tuaj të duhur, për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave që janë identifikuar në vazhdimësi nga ana jonë, në rekomandimet e mëparshme të dërguara për këtë qëllim.

Tejzgjatja e kësaj procedure administrative në të tilla afate, e vlerësuar në një këndvështrim më të gjerë, përbën premisa për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi ky parim presupozon në thelb, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti. Kjo siguri duhet të jepet nga ana e shtetit jo vetëm në pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe në garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, në marrëdhëniet juridike që ai krijon me ta, duke patur gjithmonë në fokus respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme, të njeriut.

Ky vlerësim analitik bazohet në parimin kushtetues se, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është jo vetëm një e drejtë e individit, por edhe detyrim parësor kushtëzues në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore.

Sipas dispozitave të legjislacionit specifik, në fuqi, dhe më konkretisht të ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, tashmë është detyrim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që për çdo vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal të paraqitur nga subjektet e ndryshme, të nxjerrë një vendim përfundimtar

¹⁰ Me përjashtim të rasteve të pezullimit sipas neneve 17, pika 5, 27, pika 2, 28 dhe 29 të ligjit nr. 20/2020, *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të dalë me vendim për legalizimin ose jo të ndërtimit pa leje, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit në terren, sipas datës së aktit të evidentimit në terren”.

për përmbylljen e procedurës administrative, të iniciuar pikërisht nga vetëdeklarimi i kryer nga këto subjekte.

Duke patur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë, si në raport me garantimin e të drejtës së pronësisë së shtetasve, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik të vendit, një rëndësi parësore merr gjetja e zgjidhjeve konkrete për trajtimin e aplikimeve për legalizimin e ndërtimeve pa leje, përkundër zvarritjes, apo neglizhencës, që sjell mostrajtimin e tyre, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo afati të arsyeshëm.

Lidhur me këtë çështje risjellim në vëmendjen tuaj, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, pasi ndryshe nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e gjykatave shqiptare, (që me shtesat që iu bënë Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017, më konkretisht neni 399/2, u përcaktua qartë “afati i arsyeshëm”), në rastin e legjislacionit administrativ, mungon një përcaktim i tillë konçiz.

Përfitojmë nga rasti të ndalemi në analizimin e asaj se çfarë mund të konsiderohet afat i arsyeshëm. Për analogji do i referohemi trajtimit që i është bërë këtij koncepti nga praktika gjyqësore, si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GjEDNj*) – Vendimi nr. 12, tetor 2021 “*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*”, ashtu edhe nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, (Vendimi nr. 33 datë 01.11.2021).

Në Vendimin nr. 12, tetor 2021 “*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*”, të GjEDNj-së, në pikën 49, paragrafi 4. *Zhvillime në lidhje me zgjidhjen përshpejtuese dhe kompensuese: - Funksionimi dhe efienca e zgjidhjes*, kjo gjykatë shprehet se, citojmë:

“Që prej muajit nëntor 2017, në Shqipëri ka funksionuar një zgjidhje e re përshpejtuese dhe kompensuese për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore. Ajo zbatohet për procedurat në të gjitha gjykatat penale, civile dhe administrative, për hetimet penale dhe procedurat e zbatimit të vendimeve. Ajo nuk zbatohet për procedurat në organet administrative, për të cilat autoritetet janë të mendimit se ka mjaftueshëm garanci legjislative”, që qeveria shqiptare ka dhënë garanci se, ka garanci të mjaftueshme legjislative që procedurat të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

Po në këtë vendim të GjEDNj-së, në paragrafin 94, kjo gjykatë shprehet se, citojmë:

“.... Gjykata përsërit, se pavarësisht reformave të thella në sistemin e drejtësisë dhe vonesën e kuptueshme të shkaktuar prej tyre, Shteti i paditur ka detyrimin e përgjithshëm që të organizojë sistemet e tij ligjore për të garantuar respektim të kushteve parashikuara në nenin 6§1, duke përfshirë edhe kushtin për një seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm ...”.

Në paragrafin 53, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, citojmë: “*Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregull ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shih vendimin nr. 18, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. (shih vendimet nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 22 datë 20.03.2017; nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*”, i kushtohet një rëndësi themelore respektimit të të drejtave të njeriut dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për analogji, në rastin tonë objekt ankimi do të duhej që, ju si organ publik në

trajtimin e kësaj çështjeje, të shqyrtonit aplikimin për legalizim brenda afateve ligjore përkatëse.

Ndërkohë që, në paragrafin 70, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjykata shprehet se: *“Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme, (shih vendimet nr.16, datë 16.03.2021; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 22, datë 20.03.2017; nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij ose, e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht, (shih vendimet nr. 81, datë 28.12.2015; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022, si dhe nr. 27, datë 11.04.2023, të Gjykatës Kushtetuese)”*.

Ndërsa në paragrafin 71, të po të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, thuhet se: *“GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji (shih Buchholz kundër Gjermanisë, 6 maj 1981, § 51). Metodat që mund të nxisin përkohësisht përshpejtimin janë ato kur për gjykimin e çështjeve ndiqet një radhë e caktuar e bazuar jo vetëm në datën e depozitimit të tyre, por edhe në nivelin e urgjencës dhe rëndësisë së tyre dhe në veçanti, të vlerësimit të asaj që përbën rrezik për personat në fjalë. Megjithatë, nëse një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë këto metoda nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive, (shih Guincho kundër Portugalisë, 10 korrik 1984, § 40; Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, 13 korrik 1983, § 29). Fakti që numri i lartë i çështjeve të tilla të prapambetura është bërë i zakonshëm, nuk e justifikon tejzgjatjen e proceseve gjyqësore, (shih Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, 07 korrik 1989, § 40)”*.

Pra, në arsyetimin e sipërcituar shprehet qartazi se, ngarkesa e gjykatave (për analogji në rastin tonë ngarkesa e DVASHK-ve), nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si arsye për zgjatjen e shqyrtimit të çështjeve dhe për sa më sipër, në përfundim të analizës së trajtimit të konceptit të afatit të arsyeshëm arrihet në konkluzionin se, vonesa në shqyrtimin e aplikimit për legalizim, nr. 57xx prot, Kod Unik 07-824xxxx, datë 30.01.2015, të paraqitur nga z. A. K., nuk mund të konsiderohet në përputhje me konceptin e afatit të arsyeshëm.

Në paragrafin 53, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, thuhet se: *“Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjyimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuarit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e*

autoriteteve, (shih vendimet nr.16, datë 16.03.2021; nr. 76, datë 04.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese)”).

Është me vend të theksojmë se, mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve për legalizim të ndërtimit pa leje, brenda afatit ligjor dhe/ose atij të arsyeshëm, në varësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit, të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e procedurës administrative. Kjo pasi, fakti që shtetasit për shkaqe të pavarura nga ata, nuk arrijnë të marrin një vendim përfundimtar në një procedurë administrative të iniciuar prej tyre tek organi përkatës kompetent publik, në një kohë që kanë respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, bën që ata të mos arrijnë të gëzojnë nga pronat e tyre, të drejta që ua garanton ky legjislacion.

Është e nevojshme gjithashtu, të sjellim në vëmendjen tuaj edhe përcaktimet e dhëna në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*. Kjo kartë thekson disa të drejta individuale, të rëndësishme, të cilat duhet të respektohen nga ana e organeve publike gjatë kryerjes së shërbimit publik ndaj qytetarëve.

Duke qenë se drejtoria juaj vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është një organ publik, ofrues i shërbimeve publike, do të duhej që të drejtat e garantuara të qytetarëve që kërkojnë marrjen e shërbimit publik përkatës, nga ana juaj, të mbroheshin dhe respektoheshin korrektësisht prej jush, duke i konsideruar ato si një detyrim ligjor të padiskutueshëm për zhvillimin e procedurave administrative, rast pas rasti.

Ankesa e paraqitur nga z. A. K., konstaton në fakt shkelje të të drejtave, të garantuara nga *“Karta e të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*. Trajtimi i kësaj çështjeje evidenton shkeljen e së drejtës për një zgjidhje efektive, pasi pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të ankuesit për zgjidhjen e kësaj problematike, ende sot e kësaj dite, siç edhe rezulton, nuk ka një zgjidhje konkrete.¹¹ Jo vetëm kjo, por sikurse na rezulton, ky rast konstaton shkelje të së drejtës për marrjen e shërbimit brenda afateve të asyeshme dhe marrjes së tij në mënyrë transparente,¹² si dhe shkelje të së drejtës për shërbim cilësor.¹³

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtës së qytetarëve për një administratë publike të mirë ka qënë dhe është një nga prioritetet e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe një kërkesë e theksuar në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2023, për evidentimin dhe adresimin e rasteve të keqadministrimit gjatë veprimtarisë administrative të organeve publike në vend.

¹¹ Në pikën 7, të VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*, parashikohet se:

“E drejta për zgjidhje efektive”

Ju keni të drejtë të merrni një shërbim përfundimtar për kërkesën e paraqitur. Ne ju garantojmë zgjidhje efektive për shërbimet e kërkuara, duke ju ofruar zgjidhje të shpejtë e të sigurt në favorin tuaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi...Në çdo rast, ne duhet t'ju garantojmë një vendim përfundimtar për çdo kërkesë për përfitimin e shërbimeve publike të paraqitur”.

¹² Pikat 9 dhe 10, të VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*.

¹³ Pika 18, e VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident nga ana juaj në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesit, por përkundrazi është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...,

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË:

Zhvillimin e inspektimit nga ana e Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për verifikimin e shërbimit publik ndaj ankuesit në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx, viti 2008, të kryer prej ankuesit;

Nxjerrjen sa më parë të aktit në përfundim të procesit administrative për shqyrtimin e vetëdeklarimit nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx, viti 2008, të kryer prej ankuesit;

Krijimi i platformave dhe mekanizmave që mundësojnë raportimin dhe kontrollin publik të procesit të dhënies së shërbimeve individëve kërkuar;

Ofrimi i mundësive për qytetarët dhe grupet e interesit për të monitoruar dhe raportuar çdo shkelje të mundshme;

Vendosja e një mekanizmi ligjor për të ndëshkuar ata që keqpërdorin ose dëmtojnë të drejtën gjatë ofrimit të shërbimeve.

Nxjerrjen e përgjegjësisë civile për shkeljen e parimit për zhvillimin e në procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mospërfundimit të shqyrtimit në afat të arsyeshëm ligjor të kërkesës/vetëdeklarimit nr. 5xx prot, Kod Unik 07-100xxxx, viti 2008, të ankuesit, përfshirë dëmin e mundshëm të shkaktuar atij nga veprimet e punonjësit të shërbimit ose të palëve të tjera të përfshira.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjs të argumentuar të kryhet brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga marrja dijeni.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

Erinda MELI